



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Eteam” Sh.P.K. të datës 06.12.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në Bardhosh-Bërnice - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-10826-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Eteam” Sh.P.K. të datës 06.12.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në Bardhosh-Bërnice - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-10826-5-2-1.
- II. LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III.NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV.Vendimi** hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Eteam” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 06.12.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në Bardhosh-Bërnice - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-10826-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merit (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

P.1. - *“Kërkesa që kandidati për Menaxher Projekti të jetë i certifikuar si “instruktor në vendin e punës” është e panevojshme, joproporcionale dhe pa lidhje me rolin teknik e menaxhues të një inxhinieri konstruktiv me mbi 10 vite përvojë. Ky certifikim nuk është standard profesional për pozitën e menaxhimit të projekteve në ndërtimtari dhe nuk kërkohet në asnjë kornizë teknike ose ligjore për ushtrimin e profesionit të inxhinierit”.*

P.2. - *“Kërkesa që kandidati të posedojë “certifikatë për menaxhim projektesh të lëshuar nga një institucion i njohur dhe i akredituar” në këtë formë është e kufizuar dhe e paqartë, pasi termi institucion mund të nënkuptojë vetëm institucione shtetërore apo akademike, duke përjashtuar në mënyrë të panevojshme kompanitë profesionale të akredituara që ofrojnë trajnime të standardizuara për menaxhim projektesh”.*

P.3. - *“Kërkesa që kandidati të jetë “i licencuar nga Oda e Gjeodetëve të Kosovës” është e pajustificueshme dhe në kundërshtim me rregullimin zyrtar”.*

P.4. - *“Kërkesa që Operatori Ekonomik të posedojë standardin EN ISO 1452-1:2009 është e panevojshme dhe jorelevante për natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit, i cili ka të bëjë me ndërtimin e rrugëve. Ky standard lidhet me sistemet e tubacioneve prej PVC-U për ujë të pijshëm dhe instalime të presionit, të cilat nuk përbëjnë pjesë të vëllimit të punimeve në këtë projekt dhe nuk janë të kërkuara në asnjë pozicion të paramasës”.*

P.5. –

- *Kërkesa për pajisjen “Makineri për prerjen dhe gryerjen e asfaltit, minimum 40 ton” është e panevojshme dhe jorelevante për këtë projekt, pasi në paramasat e punimeve nuk figuron asnjë pozicion që kërkon gryerje të asfaltit. Prandaj kërkojmë që: kriteri për makinerinë e gryerjes së asfaltit 40 ton të hiqet plotësisht, pasi nuk kërkohet as nga projekti, as nga natyra e punimeve.*
- *Kërkesa që mini damperi të ketë peshore digjitale është e panevojshme dhe jorelevante për natyrën e këtij projekti. Prandaj kërkojmë që: kërkesa për peshore digjitale të hiqet, duke mbetur vetëm kërkesa për kapacitetin minimal të mini damperit (4 ton).*
- *Pajisja nuk ka aplikim praktik në vëllimin e punimeve dhe vendosja e saj përbën kriter të tepruar, që rrit kostot pa kontribuar në realizimin e kontratës. Prandaj kërkojmë që: kërkesa për reflektorë me gjeneratore të hiqet plotësisht, pasi nuk është e nevojshme për natyrën dhe vëllimin e punimeve të këtij projekti.*
- *Kërkesa për pajisjen “Skeleri komplet (rama, anësore, mbrojtëse dhe shkelëse) min. 1000 m²” është e panevojshme dhe jorelevante për këtë projekt, pasi në paramasat e punimeve nuk parashikohet asnjë ndërtim i lartë që të kërkojë përdorimin e kësaj pajisjeje. Prandaj kërkojmë që: kërkesa për skelerin komplet min. 1000 m² të hiqet plotësisht, pasi nuk ka aplikim praktik në natyrën dhe vëllimin e punimeve të këtij projekti.*
- *Kërkesa që makina për montim të kubezave dhe anësoreve të betonit të ketë kapacitet minimum 1.2 ton është e tepruar dhe jorelevante për këtë projekt. Prandaj kërkojmë që: kriteri për kapacitetin minimal 1.2 ton të modifikohet, duke lejuar makina me kapacitete të përshtatshme për montimin e kubezave dhe anësoreve të parashikuara në projekt.*

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, në DT është kërkuar që menaxheri i projektit të jetë edhe instruktor në vendin e punës. Duke marrë parasysh natyrën dhe qëllimin e këtij projekti, është e domosdoshme që menaxheri i projektit të ketë aftësitë e nevojshme profesionale për menaxherimin profesional, efikas dhe efektiv të projektit, ndër të tjera edhe instruktor në vendin e punës. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka argumentuar pse nuk duhet të qëndroj kjo kërkesë në DT. Prandaj P.1 është e pabazuar.

Lidhur me P2, në DT është kërkuar shumë saktë dhe drejtë që certifikata të jetë lëshuar nga një institucion i njohur dhe i akredituar në Kosovë. Kjo pjesë është absolutisht e domosdoshme dhe nuk mund të ndryshohet. Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me P3, licenca e odës së gjeodetëve është e domosdoshme dhe nuk mund të largohet pasi që të gjithë inxhinierët në Kosovë duhet të kenë licensa sipas ligjeve në fuqi.

Lidhur me P4, standardi ISO i kërkuar është absolutisht i domosdoshëm për të siguruar cilësinë minimale të punimeve në këtë projekt. Duke qenë se këtë standard e përmbushin pothuajse të gjitha kompanitë që merren me projekte të kësaj natyre në Kosovë, kjo kërkesë është shumë e zakonshme pra e domosdoshme dhe si e tillë nuk ka aspak natyrë diskriminuese apo favorizuese sikurse ka pretenduar parashtruesi. P.4 është i pa bazë.

Ndërsa lidhur me pajisjet e kërkuara me DT të cilat potencohen sipas P.5, bëhet fjalë për makineri themelore absolutisht të domosdoshme përmes të cilave do të realizohen punimet në këtë projekt. Prandaj edhe pretendimet për pajisje janë të pabazuara në tërësi.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë shqyrtuar secila një nga një dhe me këtë rast është gjetur se këto pretendime të pabazuara. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 16.12.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.

Faqe 3 nga 3

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net